

MËSIMI DIGJITAL




"Kapacitetet digitale në shkollat e mesme të larta të komunës së Prizrenit"



KCDE - Mëso Online
Kosova Center for Digital Education



CFLI/FCIL
Canada Fund for Local Initiatives
Fonds canadien d'initiatives locales





KYC

Prishtinë 10000, Kosovë
kyckosova@gmail.com
+383 (44) 96 45 75

Dizajni: Sh.P.K. "SUKI"

"Kosovar Social Urban Inovation"

Të drejtat e autorit © 2022. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

07

Hyrje

08

Analiza e
Situatës

09

Metodologjia

10

Analiza e të
dhënave

20

Përfundimi dhe
Rekomandimet

21

Limitimet dhe
Referencat

Kosovar Youth Council - KYC

Këshilli Rinor Kosovar (KYC) është një nga organizatat më të vjetra joqeveritare rinore e themeluar në vitin 1999 në kampet e refugjatëve në Shqipëri, dhe e regjistruar zyrtarisht më vonë gjatë atij viti në Prishtinë, Kosovë. KYC u themelua si përgjigje ndaj nevojave të të rinjve kosovarë, të cilët ishin përballur me sfida të shumta të shkaktuara nga dëbimi masiv nga shtëpitë e tyre gjatë luftës së vittit 1999.

Deri më tani, KYC ka aspiruar të veprojë dhe të ndërtojë një shoqëri civile përmes iniciimit dhe përkrahjes së organizatave rinore, angazhimit të të rinjve dhe të rejave në proceset e ndryshimit, forcimi i kapaciteteve të tyre, përfaqësimi i zërit të tyre, promovimi i edukimit të vetëorganizuar dhe mbështetja e zhvillimit të politikave rinore. Rinia është në qendër të organizatës dhe e gjithë puna zhvillohet në bazë të këtyre kanaleve: stafit, vullnetarëve dhe strukturave përfaqësuese si ajo e nxënësve të shkollave të mesme – Këshilli i Nxënësve të Kosovës (KNK).

KYC bashkëpunon me institucionet arsimore, organizatat jo-fitimprurëse, institucionet publike dhe institucione të tjera, për të ruajtur një shkallë të lartë të mirëqenies, edukimit dhe aktivizmit të të rinjve në komunitetet e tyre.

Përveç kësaj, KYC angazhohet në trajtimin e rasteve individuale, me njerëz të të gjitha moshave, gjinive, etnive, orientimeve seksuale dhe nevojave të veçanta. Për më tepër, KYC mbështet institucionet në promovimin e qasjes gjithëpërfshirëse në programet dhe operacionet e tyre për të krijuar një frysë më të përgjegjshme ndaj zërave dhe nevojave të të rinjve.

Në 23 vitet e fundit, me një punë të vazhdueshme dhe të palodhshme KYC ka arritur të krijojë marrëdhënie të mira me të gjitha institucionet arsimore në vend, të angazhohet drejtpërdrejt në mënyrë holistique me të rinjtë dhe të ndërtojë kapacitetet e tyre për aftësim akademik dhe në përbushjen e qëllimeve të tyre profesionale.

Rezultat i një qasjeje të tillë ka rezultuar në lindjen e një sër liderësh të rinj të cilët kanë kaluar nëpër strukturat e KYC duke u eksposuar praktikave aftësuese dhe ndërtuese të organizatës.

HYRJE

Në janar 2021 penetrimi i internetit në Kosovë ishte 91.0% ose 1.76 milionë përdorues të internetit. Vetëm ndërmjet viteve 2020 dhe 2021, numri i përdoruesve të internetit në Kosovë është rritur për 156 mijë ose +9.7% (Kemp, 2021). Të dhënrat nga STIKK, Shoqata e TIK-ut e Kosovës, tregojnë se edhe pse me numër të lartë të përdoruesve të internetit TIK-u ende përdoret kryesisht për qëllime argëtimi.

Për dallim prej gjendjes në nivel të përgjithshëm, gjendja me këto aspekte në institucionet edukative, arsimore, aftësuese, shkencore e akademike nuk duket të jetë kaq e mirë, veçanërisht në ato të arsimit parauniversitar.

Procesi i adoptimit të teknologjisë digitale për qëllim të avancimit të arsimitështë shumëdimensional dhe për Kosovën nënkupton investime në infrastruktur si dhe krijimin e shërbimeve dhe materialeve digitale, gjithashtu edhe zhvillimin e kompetencave digitale për nxënësit dhe mësimdhënësit.

Sasia dhe cilësia e përdorimit të pajisjeve si kompjuterë, projektorë, televizorë etj. ndikojnë drejtpërdrejt në përgatitjen e nxënësëve për një botë gjithnjë e më digitale. Për më tepër, përdorimi i këtyre pajisjeve nga mësimdhënësit për të zhvilluar një orë mësimi i inkurajon nxenesit t'i përdorin ato gjithashtu, duke u mundësuar atyre që të funksionojnë herët në një mëdis digital dhe pajisur me aftësitë e nevojshme për të ndjekur një karrierë relativisht më fitimprurëse.

Ky hulumtim i shkurtër kërkimor është zhvilluar për të kuptuar kapacitetet digitale në shkollat e mesme të larta specifisht në komunën e Prizrenit.

ANALIZA E SITUATËS

Sipas Sistemit per Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA) të dhënat e anlizave tregojnë se numri total i kompjuterëve në të gjitha Institucionet Edukative-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) publike të Kosovës është 9,138 ose **1 kompjuter për rreth 35 nxënës në IEAA-të publike të Kosovës**. Këto përpjesëtime nuk janë të krahasueshme me ato në vendet e BE-së ku një kompjuter në shkollë është në dispozicion për 3 deri në 7 nxënës.

Përveç kompjuterëve, sipas të dhënave të pjesshme të SMIA-s të ofruara për përpilimin e Strategjisë së Arsimit (shtator 2021), në të gjitha IEAA-të publike janë 1753 projektorë, 191 Smart Board, 502 Smart TV, 727 makina fotokopjuese, 851 printerë, 247 tabletë, 11 skanerë (këta numra nuk paraqesin numrin e pajisjeve të cilat janë funksionale, sepse nuk dihet në çfarë gjendje teknike gjenden ato) [1].

Kosova gjindet në fazën fillestare të zhvillimit digjital të arsimit. Mirëpo, ende nuk ekzistojnë materiale mësimore digitale shumë-dimensionale, të cilat në varësi dhe “në përputhje me specifikat e lëndës mësimore, fushës kurrikulare, nivelit e klasës, përbajtjet do t'i kenë në disa formate të ndryshme, përfshirë pjesët tekstuale dhe audio-vizuale të niveleve të ndryshme (mësimi i diferencuar), aparaturë didaktike interaktive, laborator virtual, animacione, ushtrime e detyra shtëpie të niveleve të ndryshme (mësimi i diferencuar), si dhe lojëra edukative për nxënësit” (Strategjia e Arsimit 2022-26).

Mangësia në materiale shumë-dimensionale krijon hendek të drejtpërdrejt në zhvillimet e aftësive digitale. Ajo çka nënkuptohet me materiale mësimore digitale shumë-dimensionale është digitalizimi i teksteve shkollore në formatet multimediale, të cilat përbajnë 3D animacione, video, audio, galeri me foto, teste, pyetësorë, materiale PDF, word dhe PPT, të cilat mund të qasen falas dhe lehtësisht si nga mësimdhënësit, nxënësit ose prindërit.

Përvec mungesës së materialeve digitale, mungesa e infrastrukturës së duhur digitale si në nivel institucional ashtu edhe në atë personal ka shkaktuar “humbje në të mësuarit” në mesin e nxenesve në Kosovë në vitet e fundit, duke rritur gjasat që ata të mbeten më prapa kolegëve të tyre në rajon (Trupia dhe Madhi 2021). Përderisa mundësitet në fushën e arsimit mund të rriten përmes qasjes së barabartë në mësimin elektronik dhe teknologjinë, me goditjen e pandemisë COVID-19, institucionet e Kosovës nuk arritën t'i ofrojnë përfitimet e shumta të saj kur viheshin në praktikë (Spitler. A., 2022).

METODOLOGJIA

Studimi "Kapacitetet digitale në shkollat e mesme të larta të komunës së Prizrenit" është përgatitur për të kuptuar kapacitetet digitale në shkollat e mesme të larta në komunën e Prizrenit.

Metodologjia e instrumetit matës (pyetesori) për kapacitetet digitale në shkolla është zhvilluar dhe dizajnuar nga Kosova Center for Distance Education - Mëso Online (KCDE), ndërkaq ky hulumtim realizohet në kuadër të projektit EYE On i implementuar nga KYC dhe i përkrahur nga Canada Fund for Local Initiative (CFLI).

Për të kuptuar gjendjen reale në aspektin e digitalizimit në të cilën gjenden këto shkolla pjesëmarrës në këtë hulumtim kanë qenë të gjithë drejtoret e këtyre shkollave si dhe përfaqësuesit e Këshillit të Nxënësve të shkollave gjegjëse gjithsej 14 të anketuar.

Katër nga gjithsej shtatë shkolla sa janë anketuar kanë mbi 1000 nxënës, një nga këto shkolla ka rreth 800 nxënës kurse vetëm dy janë me numër më të vogël të nxënësve.




Tabela 1. Demografia

ANALIZA E TË DHËNAVE

Ndër qëllimet kryesor të këtij hulumtimi është pasqyrimi i nevojave të nxënësve të shkollave dhe duke theksuar këtu digjitalizimin e sektorit të arsimit. Nga ky hulumtim ne jemi munduar të kuptojmë përdorimin e digjitalizimit në rritjen e kualitetit të procesit të arsimit në shkollat e mesme të larta të Komunës së Prizrenit.

Sic edhe shihet në tabelen 1 në seksionin e Metodologjisë, këto shkolla mund të konsiderohen si shkolla me numër të madh të nxënësve, e që shpesh herë objekti fizikë nuk i perm bush të gjitha kriteret për një zhvillim adekuat të procesit mësimor. Nga per gjigjet e të anketuarve mund të shihet që edhe disa nga shkollat me numër të madh të nxënësve nuk kanë hapësirat e nevojshme fizike për të plotësuar infrastrukturën e nevojshme digitale. Edhe pse me një numër të konsiderueshëm të klasave fizike këto shkolla kanë mungesë të laboratorëve kompjuterik. Shkollat "Luciano Motroni", "Lorenc Antoni" dhe "Gjon Buzuku" të cilat janë me numrin më të madh të nxënësve kanë vetëm nga një laborator kompjuterik. Përderisa shkolla "Gjon Buzuku" nuk ka asnjë laborator kompjuterik, nga tabela mund të shihet se numri më i madh i laboratorëve kompjuterik është 16 në shkollën "Ymer Prizreni". Dy shkollat tjera "Qendra e Kompetences Prizren" dhe ajo "11 Marsi" posedojnë nga 9 laboratorë kompjuterik.




Tabela 2. Hapësira fizike në shkolla

Për të kuptuar infrastrukturën digjitale të këtyre shkollave drejtoret kanë treguar numrin e saktë të pajisjeve që posedojnë shkollat e tyre, duke përfshirë numrin e kompjuterëve, projektorëve, TV-ve dhe tabelave të menqura (smartbordëve). Katër nga gjithsej shtatë shkolla kanë mesatarisht 20 kompjuter në shkollat e tyre kurse tri shkolla kanë një numër më të lartë të kompjuterëve në mes të 100-200 kompjuter gjithsej, njëra ndër shkollat veçohet me numër më të vogël të kompjuterëve me 10 kompjuter në gjithë shkollën.

Sa i përket projektorëve që posedojnë këto shkolla ky numer varion nga zero projektor për njëren prej shkollave deri në 30 projektor në maksimum për shkollën ekonomike Ymer Prizreni.

TV funksional, dy shkolla veçohen me një numër më të vogël të tyre vetëm 3 TV në gjithë shkollën këtu përfshihen shkollat "Lucianoo Motroni" dhe "Qendra e Kompetencës Prizre" duke u vazhduar me një rritje në shkollat tjera e numri maksimal i TV funksional është raportuar në shkollën "Remzi Ademaj" ku janë 16. Me numër më të lartë është edh shkolla "Ymer Prizreni" të cilët kanë gjithsej 11 TV funksional.

Numër konsiderueshëm më i vogël shihet në të gjitha shkollat për posedimin e tabelave të menqura (smartboards). Tre nga shtatë shkollat nuk posedojnë asnjë tabelë të menqur, një nga shkollat ka raportuar vetëm dy tabela të menqura, dy shkolla të tjera posedojnë nga tre tabela të menqura, dhe vetëm njëra nga shkollat veçohet me posedimin më të lartë të tyre gjithsej 7 tabela të menqura në gjithë shkollën.




Tabela 3. Pajisjet digjitale në shkolla

Të gjitha shkollat kanë raportuar se kanë qasje në internet dhe shpejtesia e tij varion nga 20mbps deri ne 100 mbps ajo çka vlen të përmendet është se sa i përket shtrirjes së internetit në shkolla drejtorët dhe nxënësit kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Pothuajse të gjithe kanë treguar se zyra e drejtorit dhe salla e mësimdhënësve kanë qasje në internet. Por, gjashtë drejtor nga gjithesej shtatë prej tyre kanë raportuar se kanë shtrirje të internetit në klasa dhe koridore përderisa tek nxënësit vetëm katër prej tyre janë shprehur se klasat dhe koridoret kanë qasje në internet. E njëjtë është gjithashtu për bibliotekën dhe laboratorët ku pesë drejtorët janë shprehur se ka mbulueshmeri të internetit në këto hapësira por sipas nxënësve vetëm dy prej tyre kanë thënë që ka shtrirje të internetit në biblioteka si dhe katër prej tyre kanë thënë që laboratorët kanë qasje në internet.




Tabela 4. Shtrirja e internetit përgjigjet e drejtorëve




Tabela 5. Shtrirja e internetit përgjigjet e nxënësve

Drejtorët dhe nxënësit e kane përshkruar gjendjen aktuale digitale në shkollat e tyre si të mirë. Gjysma e të anketuarve janë shprehur se gjendja digitale në shkollat e tyre është e mirë, nga totali gjithashtu 21% kanë thënë që kushtet digitale në shkollat e tyre janë në nivel, të kënaqur me gjendjen digitale janë shprehur edhe 14.3% e te anketuarve kurse njëra nga shkollat ka treguar se janë duke punuar në digjitalizimin e shkollës së tyre.




Tabela 6. Gjendja digitale në shkolla

Të anketuarit kanë zgjedhur platformat digitale të cilat ata i përdorin më së shpeshti në proceset mësimore. Google Clasroom dhe Zoom veçohen si platformat me përdorueshmerine me te lartë për zhvillimin e procesit mësimor. Afër 30% e nxënësve janë shprehur se e përdorin Google Clasroom, rreth 21% përdorin platformën Zoom, përdorim pak më të gjerë ka edhe Power Point me rreth 14%, kurse platformat tjera si BitKosova, Microsoft Excel, Microsoft word Corel Draw dhe Photoshop kanë një përdorueshmeri më të vogël prej rreth 7% secila.




Tabela 7. Platformat që përdoren në shkolla

Pjesëmarrësit në këtë pyetësor kanë treguar planet që ka shkolla për digjitalizim. Nga të anketuarit 20%, e që të gjithë ishin nxënës, janë shprehur se nuk e dinë planin që ka shkolla për digjitalizim, krijimi i kabinetave të teknologjisë dhe ditaret digitale shihen si më me prioritet nga shkollat duke u pasuar nga pajisja me tabela të menqur dhe përpilimi i planit operativ strategjik lidhur me digjitalizimin si dhe blerja e platformave digitale (softwer të financave).

- Nuk e di.
- Punimi i planit operativ dhe strategjik lidhur me digjitalizimin e shkolles.
- Ditaret digitale
- Te jete me funksional (probleme me rrjetin, servisimi i pajisjeve)
- Krijimi i një kabineti të teknologjisë
- Nese do kemi qasje te blejm softwer te kontabilitetit, spss edhe të IT do ishte e preferueshme
- Pajisja me tabela të menqura




Tabela 8. Plani aktual i shkollave për digjitalizim

Gati gjysma e të anketuarve si nxënësit ashtu edhe drejtoret janë shprehur se mungesa e pajisjeve digitale mbetet si njëra ndër pengesat kryesore për zhvillimin e proceseve digitale pas kësaj me më shumë se 30% janë shprehur se edhe mos-përgatitja e mësimdhënësve dhe stafit të shkollës është njëra ndër arsyet që e pengojnë digjitalizimin e procesit arsimor. Arsyet e tjera janë edhe mos-gatishmëria e mësimdhënësve, rezistenca nga prindërit (duke përfshirë arsyet e ndryshme e njëra ndër to do të ishte edhe se prindërit nuk lejojnë që fëmijët të mbajn telefonë në shkollë ose prindërit nuk mund të përballojnë kostot e pajisjeve digitale), dhe rezistenca nga nxënësit për të kaluar në ambient digital si dhe mungesa e internetit.

- Mungesa e pajisjeve digitale
- Mos-përgatitja e mësimdhënësve dhe stafit të shkollës
- Rezistenca nga prindërit per të kaluar në ambient më digital
- Rezistenca nga nxënësit për të kaluar në ambient më digital
- Mungesa e internetit në shkollë
- Mos-gatishmëria e mësimdhënësve




Tabela 9. Pengesat për zhvillimin e digjitalizimit

Sipas të anketuarve pjesa praktike dhe ajo teorike e lëndëve mësimore shihen si proceset edukativo-arsiomore më të rëndësishmet që duhet të digjitalizohen nga gjithsej shtatë drejtor dhe 7 nxënës (Përfaqësues të Këshillit të Nxënësve) të shkollave të larta të Prizrenit, nëntë prej tyre kanë prioritizur digjitalizimin e këtyre proceseve. Detyrat e shtëpisë është procesi ardimor të cilën e kanë zgjedhur si më pak të rëndësishëm për tu digjitalizzuar në bazë të përgjigjjeve të marra.




Tabela 10. Proseset edukativo-arsimore që duhet të digjitalizohen

Përveç proceseve edukative rol kyç për zhvillimin e kapaciteteve digjitale në shkolla ka edhe digjitalizimi i proceseve administrative. Sipas përgjigjjeve të dhëna shihet se regjistrimi i nxënësve, vijueshmëria e mësimdhënësve dhe nxënësve shihen si proceset më të rëndësishme administrative duke vazhduar pastaj edhe me vlerësimin e nxënësve në mënyrë digjitale.




Tabela 11. Proseset administrative që duhet të digjitalizohen

Duke përfshirë të gjithë pjesëmarrësit në këtë pyetësor, 77% e tyre e kanë cilësuar përdorimin e teknologjisë si shumë të shprehur për mësimdhënien, 17% e kanë cilësuar si mesatar përdorimin e internetit për mësimdhënien dhe pjesa tjeter si pak të përdorur.




Tabela 12. Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënien

Përgatitja e mësimdhënësve për përdorimin e pajisjeve digitale është një nga kriteret kryesore për digjitalizimin e arsimit. Afër 43% e pjesëmarrësve i kanë cilësuar shumicën e mësimdhënësve të përgatitur për përdorimin e pajisjeve digitale, gjithashtu 21% e anketuesve tjerë kanë thënë se mësimdhënësit janë mesatarisht të përgatitur për përdorimin e rregullt të pajisjeve digitale. Pjesa tjetër 21.4% e tyre i kanë cilësuar si të papërgatitur dhe që ju nevojiten trajnimet adekuate. Si arsyë për mos përgatitje për përdorim të rregullt të pajisjeve digitale ata e kanë cilësuar edhe moshën e shtyer të mësimdhënësve.




Tabela 13. Përgatitja e mësimdhënësve

Përveç njohurive për përdorimin e pajisjeve digitale mësimdhënësit duhet të kenë njohuri edhe të platformave digitale. Platforma shkollore digitale nënkupton një sistem të mirorganizuar që ndihmon, zhvillon dhe mundëson lehtësimin e procesit mësimor, përdorimi i platformave të tilla ofron ndërveprim online në mes të nxënësve dhe mësimdhënësve. Mbi 61% e nxënësve dhe drejtorëve i kanë cilësuar mësimdhënësit si mjaftë të përgatitur për përdorimin e platformave digitale të cilat, pjesa tjeter i kanë cilësuar si të papërgatitur duke shprehur se ju nevojiten trajnime për përdorimin e këtyre platformave, e disa kanë cilësuar se mosha e shtyer është përsëri një pengesë për mësimdhënësit në përdorimin e rregullt të platformave digitale.




Tabela 14. Përgatitja e mësimdhënësve

Më shumë se 40% e drejtorëve dhe nxënësve të shtatë shkollave pjesëmarrëse në këtë pyetësor e kanë vlerësuar gatishmërinë momentale të shkollave për kalimin nga mësimi tradicional në atë digjital si mesatar, afér 40% e kanë vlerësuar atë me numrin pesë duke i cilësuar si shumë të përgatitur, gjithashtu pjesa tjeter më shumë se 15% e kanë zgjedhur numrin katër që kalon mesataren e përgatitjes.




Tabela 15. Gatishmëria për mësim digjital

Për të kuptuar qasjen e nxënësve ndaj digjitalizimit ata janë pyetur nëse digjitalizimi përmirson procesin e mësimdhënies dhe 85.7% janë shprehur se po, vetëm 14.3% nuk mendojnë se digjitalizmi përmirson procesin e mësimdhënies.




Tabela 16. Përmirësimi i mësimdhënies me digjitalizim

Për të kuptuar përgatitjen e mësimdhënësve, pjesëmarrësit janë pyetur edhe për trajnime që ndihmojnë në aftësimin e përdorimit të platformave dhe pajisjeve digitale. Më shumë se 40% i kanë cilësuar këto trajnime si shumë të nevojshme, 21% e tyre kanë thënë që vetëm një pjesë e mësimdhënësve kanë nevoj për trajnime, pjesa tjeter kanë cilësuar se mësimdhënësit kanë nevojë për trajnime në platforma të caktuara, dhe se trajnimet janë mesatarisht të nevojshme. Një pjesë e vogël nuk e shohin të nevojshëm trajnimin e mësimdhënësve për përdorimin e pajisjeve dhe platformave digitale.




Tabela 17. Trajnimi për përdorim të platformave dhe pajisjeve digitale

Për të kuptuar infrastrukturën digjitale të këtyre shkollave drejtoret kanë treguar numrin e saktë të pajisjeve që posedojnë shkollat e tyre, duke përfshirë numrin e kompjuterëve, projektorëve, TV-ve dhe tabelave të menqura (smartbordëve). Katër nga gjithsej shtatë shkolla kanë mesatarisht 20 kompjuter në shkollat e tyre kurse tri shkolla kanë një numër më të lartë të kompjuterëve në mes të 100-200 kompjuter gjithsej, njëra ndër shkollat veçohet me numër më të vogël të kompjuterëve me 10 kompjuter në gjithë shkollën.

Sa i përket projektorëve që posedojnë këto shkolla ky numer varion nga zero projektor për njëren prej shkollave deri në 30 projektor në maksimum për shkollën ekonomike Ymer Prizreni.

TV funsional, dy shkolla veçohen me një numër më të vogël të tyre vetëm 3 TV në gjithë shkollën këtu përfshihen shkollat "Lucianoo Motroni" dhe "Qendra e Kompetencës Prizre" duke u vazhduar me një rritje në shkollat tjera e numri maksimal i TV funsional është raportuar në shkollën "Remzi Ademaj" ku janë 16. Me numër më të lartë është edh shkolla "Ymer Prizreni" të cilët kanë gjithsej 11 TV funsional.

Numër konsiderueshëm më i vogël shihet në të gjitha shkollat për posedimin e tabelave të menqura (smartboards). Tre nga shtatë shkollat nuk posedojnë asnjë tabelë të menqur, një nga shkollat ka raportuar vetëm dy tabela të menqura, dy shkolla të tjera posedojnë nga tre tabela të menqura, dhe vetëm njëra nga shkollat veçohet me posedimin më të lartë të tyre gjithsej 7 tabela të menqura në gjithë shkollën.

PËRFUNDIMI

Në bazë të përgjigjeve nga pjesëmarrësit mund të vërehet se infrastruktura digitale në këto shkolla është e dobët. Edhe pse me numër mjaft të lartë të nxënësve që vijojnë mësimin në këto shkolla ato nuk kanë kushtet ideale për të përbushur nevojat e secilit nxënës. Në shumicën e shkollave mungojnë laboratorët kompjuterik gjithashtu edhe pajisjet digitale si kompjuterët, TV-ët, projektorët, tabelat e menqura etj. Pajisjet digitale të cilat janë në numër mjaftë të vogël zakonisht përdoren nga mësimdhënësit. Të gjitha shkollat kanë qasje në internet por shtrirja e tij nuk është në gjithë objektin shkollor, sipas deklarimeve të nxënësve interneti nuk funzionon në klasa, koridore ose edhe biblioteka, kjo bënë të pamundur për nxënësit edhe përdorimin e pajisjeve digitale personal që do të ndihmonin zhvillimin e procesit mësimor dhe inkluadrimin e materialeve digitale në klasa.

Përveç infrastrukturës digitale procese të ndryshme si edukativo-arsimore por gjithashtu edhe ato administrative janë të nevojshme të digjitalizohen për të krijuar një ambient digjital dhe lehtë të qasshëm që plotëson nevojat e të gjithë akterëve. Sipas pjesëmarrësve në këtë pyetësor mësimdhënësit dhe nxënësit janë të gatshëm të kalojnë në mësimin digjital nga ai tradicional, edhe pse arsyë si mosha e mësimdhënësve dhe mos njohuria për pordorimin e pajisjeve dhe platformave digitale është pengesë për mësimdhënësit. Digjitalizimi përmirëson procesin e mësimdhënieς por që të arrihet niveli i dëshirueshëm mësimdhënësit duhet të ndjekin trajnime që ndihmojn ata në njohjen dhe përdorimin e platformave dhe pajisjeve të ndryshme janë shprehur të anketuarit.

LIMITIMET

Ndërsa gjetjet e këtij hulumtimi janë të rëndësishme, ekzistojnë disa kufizime që duhet të merren parasysh për kërkime të mëtejshme. Mostra për këtë hulumtim të shkurtër kërkimor nuk përfshiu mësimdhënësit kjo krijon mangësi në vlerësimin e gjendjes në të cilën gjenden shkollat e mesme të larta që ishin targeti ynë. Gjithashtu perspektiva e mësimdhënësve është veçanërisht e rëndësishme për të kuptuar gatishmërin e tyre për kalimin në mësim digjital si dhe njohuritë që ata posedojnë tashmë ose që mendojnë se janë më të rëndësishme për të i zhvilluar.

Në këtë kërkim janë përfshirë Përfaqësuesit e Këshillit të Nxënësve të të gjitha shkollave të mesme të larta të Prizreni. Edhe pse të përfaqësuar nga ta zgjedhurit e tyre një studim që do të përfshinte numër më të madh të nxënësve do të shërbente të vërtetohet saktësia e këtyre konstatimeve dhe gjithashtu do të krijonte perspektiva të reja që do të ndihmonë për të kuptuar më mirë kapacitetet digjitale në shkollat e mesme të larta specifisht në komunën e Prizrenit.

REFERENCAT

- **Kemp, S. (2021). Digital in Kosovo: All the Statistics You Need in 2021.**
<https://datareportal.com/reports/digital-2021-kosovo>
- **Spiteler. A., 2022, DISCONNECTED Inequality and "E-Learning" in COVID-Era Kosovo**
<http://kcde-ks.org/wp-content/uploads/2022/10/Spitler-Aaron-HIA-KCDE-Report-V3.pdf>
- **INTERNATIONAL TRENDS AND INNOVATION IN CAREER GUIDANCE - Europa**
https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2020-06/digital_factsheet_kosovo.pdf
- **Draft Strategjia e Arsimit 2022-2026**
<https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/14-54-14-17062022/1.-Draft-Strategjia-e-Arsimit-2022-2026-Sq.docx>



